VENDIM
Nr.90, datë 6.8.2008

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "BIOPOWER GREEN ENERGY" SHPK

(Ndryshuar me vendimin nr. 251, datë 21.12.2020[1])

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, germa "a", 8, si dhe 15, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 5, 13, si dhe 14 të "Rregullores për procedurat e licencimit", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6. 8.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k. për t'u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik BPGE1 dhe BPGE 2,

Konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të "Biopower Green Energy" sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.54 datë 29.5.2008.

2. Ligji nr.9913, datë 5.5.2008" Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" nuk parashikon të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Në lidhje me ndërtimin e këtij parku, shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k., në aplikimin e saj për t'u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, e bazon studimin e prefizibilitetit në të dhëna historike të regjistruara të erës, të matura në lartësi të ndryshme nga ato në të cilat do të punojnë gjeneratorët.

4. Oponenca tekniko–ekonomike është paraqitur pranë AKBN, e cila ende nuk është shprehur mbi këtë projekt.

5. Ligji për sektorin e energjisë elektrike parashikon në nenin 15 autoritetin e ERE-s për vendosjen e kushteve të çdo licence.

Për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Biopower Green Energy" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parqet eolike BPGE 1 dhe BPGE 2, me kusht zbatimin përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës dhe përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

b) Shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k. duhet paraqesë pranë ERE-s marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara

---

[1] *vendimi nr. 251, datë 21.12.2020 i ERE-s vendosi shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes mbi "Kërkesën e shoqërisë 'Biopower Green Energy' sh.p.k., për zgjatjen me 36 muaj të afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar.*

detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.

c) Shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k. do të respektojë detyrimet e Shërbimit Publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

d) Shoqëria duhet të paraqesë pranë ERE-s oponencën tekniko-ekonomike nga ekspertë të licencuar brenda 60 ditëve nga lëshimi i licencës.

e) Koha e zbatimit e të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës të jetë 36 muaj.

f) Mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta